

VENDIM
Nr. 194, datë 21.7.2022

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “GREEN ENERGY BILISHT” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37 pika 2, germa “a”, dhe nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5 pika 1, germa “a”, nenit 10, pikat 4, 5 dhe 6, dhe nenit 13 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.7.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1144/1 prot., datë 19.7.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Green Energy Bilisht” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 80, datë 13.4.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Green Energy Bilishti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2000 kW.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE me shkresën nr. 70/9 prot., datë 20.4.2022, bëri njoftimin në media për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve dhe objeksioneve (datë 3.5.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla. ERE, me shkresën nr. 448/1 prot., datë 21.4.2022, njoftoi shoqërinë për vendimin e Bordit nr. 80/2022, duke i evidentuar dhe dokumentacionin e munguar apo të plotësuar pjesërisht nga ky aplikim.

- Duke qenë se nuk u depozitua dokumentacion nga ana e shoqërisë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 128, datë 31.5.2022, vendosi të refuzojë licencimin e shoqërisë “Green Energy Bilishti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2000 kW.

- Në të njëjtën datë, shoqëria ka depozituar dokumentacion me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 448/2-1 prot., datë 6.6.2022. Në vijim me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 448/3 prot., datë 7.6.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues.

- ERE, me shkresën nr. 448/4 prot., datë 9.6.2022, ka njoftuar shoqërinë për vendimin e Bordit nr. 128/2022, duke i dhënë asaj dhe udhëzimet përkatëse për riaplikim.

- Referuar përcaktimeve të nenit 10, pikave 5, 6 dhe 7, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, pavarësisht se parashikohet e drejta e aplikuesit për paraqitjen e një aplikimi të ri brenda 30 ditëve nga vendimi për mosfillimin e procedurës, dhe bazohet te neni 6, i cili nga ana e tij ka të bëjë me refuzimin e kërkesës për licencim, është e qartë se në këto rrethana kjo e drejtë i njihet aplikuesit dhe në rastet kur është marrë vendimi për refuzimin e kërkesës, pasi kushti thelbësor nuk është procedura në këtë rast, por afati, pra ka të bëjë me gatishmërinë e aplikuesit për t’iu përgjigjur udhëzimeve të dhëna nga ERE brenda 30 ditëve. Shoqëria e ka paraqitur dokumentacion brenda këtij afati, çka evidenton vullnetin dhe gatishmërinë e saj për të plotësuar sa kërkuar nga ERE.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A

të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal; dokumentacionin teknik për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike; si dhe lejet nga institucionet respektive. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim – neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b” dhe “d”.
- Dokumentacioni teknik për centralin fotovoltaiik – neni 9, pika 4.4.1, pika 4.4.2, pika 4.4.3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d” dhe pika 4.4.4, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”.
- Leje nga institucione të tjera – neni 9, pika 4.4.5, gjerat “a” dhe “b”.
- Në lidhje me kërkesën e nenit 9, pika 2, gjerat “g”, vlerësohet t’i lihet kusht shoqërisë në vendim, që të përcjellë në ERE jo më vonë se data 11.9.2038, kontratat e qirasë të rinovuar ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë.
- Në lidhje me kërkesat e nenit 9, pika 3, gjerat “c”, duke qenë se shoqëria nuk ka dokumentuar mënyrën e financimit për gjithë investimin, vlerësohet t’i lihet kusht në vendim që të depozitojë dokumentacionin respektiv për mbulimin e pjesës së mbetur të investimit, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni.

- ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga Studimi i Fizibilitetit të centralit fotovoltaiik 2 MW rezulton se jetëgjatësia e një paneli shkon 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaiike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Green Energy Bilisht” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me vendndodhje në zonën Bitinckë, Bilisht, qarku Korçë, me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 25-vjeçar.

2. Shoqëria “Green Energy Bilisht” sh.p.k. duhet të përcjellë në ERE jo më vonë se data 11.9.2038 kontratën e qirasë për zonën ku do të shtrihet projekti të rinovuar, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë.

3. Shoqëria “Green Energy Bilisht” sh.p.k. të depozitojë në ERE brenda 30 ditëve pune nga marrja dijeni, dokumentacion për mbulimin e pjesës së mbetur të investimit për ndërtimin e centralit fotovoltaiik.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga

data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti